

FJALA E DEPUTETES HATIXHE KONOMI

E ENJTE 9 MAJ 2022

E nderuar drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë,

Të nderuar qytetarë,

Qarku i Beratit, falë trashëgimisë kulturore, historisë, folklorit, bukurive natyrore, infrastrukturës gjithmonë e në përmirësim, është një qark me potencial të jashtëzakonshëm në fushën e turizmit. Ndërsa turizmi po bëhet realitet i qytetit dhe i gjithë qarkut tonë, ku po zhvillohet si asnjëherë më pare hoteleria, bujqësia, agroturizmi e agropërpunimi, më lejoni të ndalem pak në infrastrukturën rrugore në disa zona rurale, ku nevojitet ndërhyrje e menjëhershme dhe konkretisht në dy akset rrugore shumë të rëndësishme, si: rruga e fshatit Karkanjoz dhe rruga Velabisht-Dimal. Fshati Karkanjoz është një ndër fshatrat më të mëdhenj të njësisë administrative Roshnik të Bashkisë së Beratit, me rreth 260 familje, i cili shtrihet rrëzë malit të Tomor, me një bukuri natyrore të jashtëzakonshme. Karkanjozi ka të njëjtin potencial zhvillimi si Roshniku, por me të vetmen pengesë: rrugën e amortizuar prej 6 kilometrash. Përveç barrierës që kjo rrugë krijon në zhvillimin e zonës, për fat të keq, vështirëson, gjithashtu, aksesin ndaj shërbimeve sociale, shëndetësore dhe ekonomike të banorëve. Kjo zonë ka një aktivitet të spikatur bujqësor dhe blegtoral, ndaj mbështetja dhe përkrahja e tyre do të ishte një kontribut jo vetëm për Karkanjozin, por për të gjithë njësinë administrative dhe qytetin në përgjithësi. Roshniku, Karkanjozi dhe fshatrat Dardhë dhe Qafë Dardhë janë fshatra shumë premtues në fushën e agroturizmit dhe turizmit malor, prandaj kërkojnë vëmendje të veçantë për përmirësimin e infrastrukturës së tyre rrugore. Aksi tjetër rural, në të cilin do të doja të ndalesha, është rruga Velabisht-Dimal.

Njësia administrative Velabisht është një ndër njësitë më të mëdha administrative në Bashkinë e Beratit me 13 fshatra dhe me një popullsi rreth 12 mijë e 100 banorë dhe me një përqendrim të lartë të aktivitetit bujqësor. Ju patjetër që keni dëgjuar për fshatin Bilçë, i cili shquhet për kulturën e ullirit, me rreth 600 hektarë ullishte, po ashtu fshati Drobonik, i cili dallohet për pemëtari, me rreth 650 hektarë, ku mund të përmendim në veçanti qershinë, fshati Starovë me 450 hektarë të mbjella me perime të fushës është një ndër furnizuesit kryesorë të tregut të qytetit të Beratit. Për shkak të potencialit të kësaj zone në sektorin e bujqësisë, një pjesë e mirë e fermerëve kanë përfituar nga subvencionimi i naftës, por ajo që mbetet shqetësuese për këta banorë është infrastruktura rrugore, më konkretisht amortizimi i aksit rrugor Velabisht-Dimal me një gjatësi prej rreth 10,8 kilometra. Rehabilitimi i këtij aksi rrugor është shumë i rëndësishëm për banorët e kësaj njësie, sepse do ta lehtësonte daljen drejt pikave të grumbullimit të perimeve të serrave në tregun e Lushnjës apo në të tjera pika, që eksportojnë produktet perimore.

Gjithashtu, rruga Velabisht-Dimal do të krijonte mundësinë e lëvizjes së trafikut të të gjithë zonës pa hyrë në qytetin e Beratit. Potenciali turistik i zonës është tepër i lartë, duke pasur parasysh tiparet e

peizazhit, natyrës, potencialin bujqësor dhe afërsinë me qytetin e Beratit. I ndan vetëm lumi Osum. Investimet në zonë do t'i nxisin investitorët potencialë për çeljen e aktiviteteve të ndryshme në fushën e turizmit dhe agrobiznesit. Banorët e Velabishtit dhe Karkanjazit kanë shumë kohë që i presin këto investime dhe ndjeshmëria e tyre vjen si pasojë e nevojës akute për ndërhyrje, ndaj mendoj se e meritojnë tashmë vëmendjen tonë për të zgjidhur shqetësimin dhe problematikën më të madhe të zonave përkatëse. Një çështje tjetër që do të doja ta sillja në vëmendje sot është rikonstruksioni i shkollës “Babë Dudë Karbunara”. Shkolla “Babë Dudë Karbunara” është institucioni arsimor më i rëndësishëm në qytetin e Beratit. Ajo ndodhet në qendër të tij, pranë bashkisë. Është vazhdimësi e gjimnazit të parë të qytetit tonë, i cili u hap në vitin 1925. Gjimnazi u vendos në godinën ku është sot në vitin 1958. Për disa dekada kjo shkollë është renditur ndër 10 shkollat më të mira në shkallë vendi për rezultate të larta në procesin mësimor-edukativ, por, pavarësisht statusit dhe rëndësisë së madhe që kjo shkollë ka për qytetin, ajo sot gjendet përballë problematikave të mëdha që lidhen në veçanti me strukturën. Drejtoria arsimore e Bashkisë së Beratit ka treguar vëmendje maksimale, duke ofruar shërbime të vazhdueshme për këtë shkollë, por tashmë problematikave të saj nuk zgjidhen më nëpërmjet mirëmbajtjes apo riparimit.

Duke marrë parasysh vjetërsinë dhe metodat e hershme të ndërtimit, shkolla aktualisht është shumë e amortizuar. Janë nxjerrë jashtë funksionit disa klasa, biblioteka dhe palestra e shkollës. Përveç këtyre, shkolla ka nevojë për rehabilitim të kanalizimeve, të cilat shpeshherë sjellin defekte. Shkolla ka sistem ngrohës me energji elektrike, por rrjeti është i amortizuar dhe nuk ka kapacitet për të siguruar ngrohje të vazhdueshme. Gjithashtu, godina paraqitet vulnerabël ndaj forcave sizmike. Po ashtu, theksoj se klasat janë të mbingarkuara me nxënës, sepse ka mungesë mjedisesesh. Investimi në arsim është investimi më i domosdoshëm në çdo rast, por, mbi të gjitha, në rastin e Beratit, i cili ka mbi 5 vjet pa investime madhore në infrastrukturën e godinave arsimore. Një emergjencë si kjo e shkollës “Babë Dudë Karbunara” pa diskutim që duhet vendosur tashmë në prioritetet tona për ndërhyrje. Të dashur kolegë, Duke qenë se qeveria jonë ka prioritet komunikimin e vazhdueshëm me qytetarët, ne vijojmë, me të gjitha format, ruajtjen dhe intensifikimin e këtij komunikimi. Procesi i suksesshëm i Këshillimit Kombëtar na dëshmoi se ata besojnë te fuqia që zëri i tyre ka te ne, ndaj, edhe në vijim të kërkesave të tyre, i klasifikova këto tri problematika, e bindur që do t'ju jepet vëmendja e duhur në hapësirën më të parë. Faleminderit!